

BIBLIOTEKA


E

834-32
996.

SHITIT

QAMIL GURANJAKU

GJIROKASTËR



Tetë ditë pa bukë

8/11-32
g 96.

QAMIL GURANJAKU

TETË DITË PA BUKË

TREGIME

914.
BIBLIOTEKA E SHTETIT
SHKOLLORIT
37884

INSTITUTI I STUDIMEVE DHE BOTIMEVE SHKOLLORE
TIRANË, 1966

PARATHËNIE

Që kur ishte nxënës në shkollën Normale të Elbasanit, Qamil Guranjaku shquhej për sjelljen shembëllore, për vullnetin e fortë në mësim dhe për etjen e madhe që kishte të zgjeronte sa më shumë horizontin e vet kultural. Kështu spjegohet fakti që ai, duke filluar që në bankat e shkollës, iu vu mësimi të gjuhëve italisht e frëngjisht jashtë programit të shkollës dhe arriti t'i përvehtësonte këto dy gjuhë.

Qamil Guranjaku, që i ri, e deshte profesionin e mësuesisë dhe si mbaroi Normalen, filloi punën në këtë profesion me zell të madh. Si mësues i shërbeu atdheut dhjetë vjet me radhë, që nga viti 1933 gjer në vitin 1943 dhe që një ndër mësonjësit e dalluar në gjithë vendin.

Dashuria për gjuhën e për kulturë i ngjalli atij edhe pasionin për letërsinë. Që në bankat e shkollës botoi poezitë e tija të para për fëmijë si dhe skica e tregime të ndryshme. Ai që një ndër shkrimtarët më prodhons të periudhës 1930-1940, nga ata të pa përhapën menjëherë, hynë në tekstet shkollore dhe u bënë shpejt të masës. Ky gjë dëshmonte për thjeshtësinë, bukurinë artistike dhe realizimin e poezivet të tija.

Jeta si mësues e bëri Qamil Guranjakun të jetë akoma më shumë në kontakt me popullin; ai pa më afër plagët e tija dhe iu shtua akoma më shumë urrejtja kundër regjimit të Ahmet Zogut, regjim i kërbaçit e i litarit, dhe kundër bejlerëve e agallarëve, që i pinin gjakun popullit si shushunjat. Këtë urrejtje ai e shfrentë

te poezitë e tija «Ankimi i lypëses», «Me bukë e pa bukë» e në krijime të tjera.

«Nga bollëku, ngrania tepër,
Velesh beu dhe zotnia;
Kurse në i kasolle t'vjetër
Vuento nana nga uria.

At'herë turm' e vegjëlisë
Lshoi kushtrimin e lirisë:
— Gjersa uku mbetet uk,
Ai do plumb e jo pambuk!»

(Nga poezia «Me bukë e pa bukë»)

Okupacioni fashist italian më 7 prill 1939 qe thikë helmi në zemrën e popullit shqiptar. Por, ashtu sikundër nuk u përul i gjithë populli përpara armikut, ashtu nuk u përul edhe Qamil Guranjaku. Që në ditët e para ai u bashkua me rezistencën e popullit, mori pjesë në demonstratat e 7 prillit e në ato të mëvonëshmet dhe e pa okupacionin si gjëmën më të madhe që mund ta gjejë një popull.

Në luftën N. Çl. populli ynë çfaqti me një forcë të jashtëzakonëshme shpirtin e tij revolucionar, trimërinë dhe heroizmin e pashëmbëllt si dhe vendosmërinë e vetmohimin e tij. Dhe këto cilësi i mishëronte më së miri edhe figura e mësuesit të popullit Qamil Guranjaku. Ai përqafoi që në krye, pa as më të voglin ngurrim, idealët e Partisë dhe ajo me Qamilin futi në gji të saj një revolucionar të vendosur gjer në fund.

Gjatë luftës N. Çl. Qamil Guranjaku punoi e luftoi si anëtar partie: ilegal në qytetin e Elbasanit, organizator i batalionit territorial në Dumre, Shpat e Berzeshtë, komisar i grupit partizan të kreu akte trimërie individuale në qytet e në mal dhe kurrë nuk u lodh e nuk u ankua, me gjithë shëndetin e tij të dobët.

Dhe duke qenë në luftë, Qamili nuk harroi të punonte edhe për letërsinë. Në tregimin «Lashi» ai na përshkruan një aspekt të luftës ilegale në qytet. Leximi i këtij tregimi të bën të jetë tërësisht tërësisht dhe heroizmin e asaj lufte me aq rreziqe. Dhe kjo radhë të parë, çaste që i ka jetuar vetë.

Dhe më von, kur ai doli në mal, gjeti heronj të tjerë, të cilët nuk vuanin më pak, nuk ishin më pak trima e të vendosur, dhe këta heronj, që e jepnin jetën e gjakun e tyre në lufta he-

roike për idealin që i kish frymëzuar, nuk i shpëtuan Qamilit. Atij nuk i shpëtoi heroizmi i korierit të batalionit, Syrja Dylgjeri; mitralieri — Eqrem Dylgjeri; fshatari Beqir Koçi nga Orenji, i cili nuk kurseu për luftën të vetmen dhi që kishte dhe në fund edhe jetën e vet. Nuk kishin si t'i shpëtonin gjithashtu ndjeshmërisë së hollë të shpirtit të tij prej artisti edhe heronjtë, si Jorgji Dilua, Tom Xhelali e të tjerë. Këta heronj të shkrimeve të tija janë të vërtetë, janë shokë me të cilët ai luftoi e ndau bashkë me ta vortjet e luftës.

Në tregimin «Mitralieri», Qamili na përshkruan heroizmin e të riut komunist Eqrem Dylgjeri. Ai, megjithëse në moshë të njo-më, gjashtëmbëdhjetë vjeç djalë, hidhet me vendosmëri në luftë kundër armikut fashist dhe është një ndër partizanët më të vje-tër të batalionit. Duke ndjekur luftën e këtij të riu, sakrificat, trimëritë, të cilat autori na i përshkruan me vërtetësi, lexonjësit i bëhet i afërt e i dashur ky hero i tregimit. Në fund, në luftimet që zhvillohen në Myshqetë e Bërzhitë për të ndaluar forcat fa-shiste të hyjnë në Tiranë, në prag të çlirimit të atdheut, Eqremi bie heroikisht në kodrën e Ibës dhe hyn në vargun e madh të dëshmorëve për liri. Dashur pa dashur, lexonjësit, kur arrin në fund të tregimit dhe sheh Eqremin të vrarë sipër mitrolozit të tij, mbuluar nga gjaku i ngrohtë që i kullon akoma nga balli në-për faqe, i shpëtojnë lotët dhe ndjen pikëllimin më të thellë për të. Dhe ky pikëllim rritet akoma më shumë kur lexojmë: «Eqre-mit mezi ja shkëputën duart nga mitralozi, hekurin e ftohtë të të cilit ato duar nuk e ndienin më si dikur në Çermenikë, kur e prekshin dhe e limojshin ngadalë nëpër gjumë, me frikë se mos ja merrte njeri!» Ai edhe i vdekur s'donte të ndahej nga arma e vet, me të cilën pati luftuar armikun».

Në tregimin «Të vetmen dhi që kishte» përshkruhet dashuria që ka për Partinë fshatari i varfër nga Orenji, Beqir Koçi. Aty sho-him lidhjet e popullit me partizanët dhe me luftën N. Çl. Beqir Koçi kishte vetëm një dhi e asgjë tjetër, por edhe atë ballistët don-in t'ja merrnin. Ai e fshihte prej tyre duke vënë në rrezik edhe jetën. Por lufta partizane shkon gjithmonë përpara. Një ditë Orenji çlirohet dhe partizanët hyjnë në fshat. Për Beqir Koçin, që ishte i lidhur që më parë me partizanët, nuk kishte gëzim më të madh. Ai do që ta festojë këtë ditë dhe kështu, fshehur nga shokët e luf-tës, theri dhinë e vetme që kishte. Më von, ky fshatar i varfër që shpëtimin e tij e shihte vetëm tek lufta nacional-çlirimtare, mori armët e u hodh në radhët e partizanëve. Luftoi në shumë aksione si patriot i flaktë dhe më në fund ra heroikisht duke luftuar kun-dër nazistëve gjermanë e bandave tradhëtare në Zdrajshë të El-basanit.

Duke lexuar këtë përmbledhje tregimesh, aq sa të dhimbsen heronjtë që s'kursyen as jetën për lirinë e popullit, aq sa çmon sakrificat e mëdha dhe fitoret që janë arritur, po aq e urren edhe të kaluarën e egër të vendit tonë, e cila u varros një herë e përgjithmonë.

I dobësuar shumë nga lufta e gjatë, i lodhur nga puna e madhe pas çlirimit, me shëndet të dobët siç qe, Qamil Guranjaku nuk mundi t'i bënte ballë sëmundjes së rëndë që e zu në pranverën e vitit 1949 dhe më 19 qershor të atij viti vdiq.

Përveç medaljeve të luftës, Presidiumi i Kuvendit Popullor atë e ka nderuar edhe me titullin e lartë «Mësonjës i Popullit».

MOISI ZALOSHINJA

TETË DITË PA BUKË

Ishte një ditë nëntori e vitit 1943. Në qiellin e vrërët nuk dukej gjë, po që së largu dëgjohej zhurma e një aeroplani gjerman, që fluturonte mbi zonën e Çermenikës. Partizanët ishin mësuar me këto fluturime dhe i kuptonin mirë qëllimet e vrojtuesve të armikut. Nëpër qafat e shtigjet, ku përgjonin me pushkë e mitroloza, partizanët bisedonin me njeri tjetrin nëpër pozicionet e tyre: «Ja spiuni si fluturon për të diktuar forcat e pozitat tonal!»

E dinin mirë se gjermanët përgatiteshin për ndonjë operacion kundër forcave partizane. Agjentët e tyre, ballistët, përhapnin parullat, kurse aeroplanët hidhnin letra nëpër katunde e qytete që të trembnin popullin dhe ta largonin nga rruga e luftës për liri.

Partizanët e batalionit të Çermenikës, megjithëse ruanin me kohë bazat, ku misioni engles kishte premtuar se do të hidhte material luftarak e veshmbathje, kishin mbetur të xhveshur dhe të armatosur keq. Bile as brigada e dytë nuk u plotësua si duhet me materialin luftarak që zunë partizanët në aksionin e Pishkashit kundër italianëve.

Komandantët e komisarët e kompanive të batalionit raportonin gjithnjë gjendjen e keqe të armatimit e të veshmbathjes, sidomos në ato ditë që gjermanët do të fillonin një operacion të madh. Këtë gjendje e njihnin mirë edhe oficerët englezë të ndërlihdjes, mbasi kryetari i tyre, Gjen. Devis, e kishte bazën në Orejë. Por premtimet e tyre kishin mbetur në letër, se në këtë zonë gjoja kishte ciklone dhe nuk mund të fluturonin dot aeroplanët. Mirëpo partizanët, kur shikonin se në bazat e tradhëtarit Abas Kupi, si në Xibër e gjetiu, hidhej material me shumicë e më shpesh, guditëshin dhe bisedonin me shoqi-shoqin: «Si është e mundur që andej të mos ketë ciklone?».

ciklon — erë e tmerrshme me shtjellë, që kalon me shpejtësi të madhe.

Tri ditë përpara se të fillonte operacioni i dimrit, fluturoi një aeroplan englez duke lëshuar disa parashuta me material. Misioni lajmëroi komandën e grupit partizan për të marrë në dorëzim materialin. Edhe ne shkuaam në vend. Ishin katër mitralozë të lehtë, 1500 fishekë, 30 palë çorape. Pjesa tjetër përmbli dhej në ushqime, çokollata dhe gazeta për vetë oficerët englezë. Ky qe materiali i fundit, që hodhën në këtë zonë dhe me këtë do të përballonim rrebeshin e operacionit të dimrit. Sigurisht që partizanët u dëshpëruan nga ky gjest. Komanda vendosi të mos e marrë në dorëzim materialin, i cili nuk mjaftonte as për një skuadër. Me të marrë vesh vendimin e komandës së grupit, partizanët ja mfuarrën këngës «me një torbë me fishekë e një dyfek». Kjo qe përgjegjja e tyre e drejtë. Kështu e nisën luftën nacional-çlirimtare, por do ta mbaronin me topat e tanksat e armikut.

* * *

Në dhjetor të vitit 1943 gjermanët e ballistët filluan sulmet nga të tri anët: Librazhdi, Zdrajshë-Orejë e Lunik-Kostejë-Martanesh; nga Elbasani në Labinot — Shëmil-Orejë e Labinot-Guri Zi — Shëngjergj; nga Tirana në Priskë-Shëngjin-Shëngjergj. Kurse nga Burreli e Klosi hë për hë nuk drejtuan asnjë sulm, mbasi kishin aleatin e tyre besnik, Abaz Kupin me mercenarët e tij, të cilët do të pengonin forcat partizane që të mos manovrojnë në atë zonë.

Armiku kishte mjaft informata nga tradhëtarët e ballit e të legalitetit për vendosjen e forcave tona në këtë krahinë. Prandaj sulmuan më tepër me forca të shumta Çermenikën, pse kjo lidhte forcat partizane të veriut me ato të jugut, ishte në zemër të komunikacioneve Tiranë-Korçë dhe mbi të gjitha pse aty ndodheshin disa anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar dhe një pjesë e shtabit të përgjithshëm. Armiku desh të shkatërojë me çdo kusht shtabin ushtarak e politik të lëvizjes nacional-çlirimtare, në krye të të cilit qendronte udhëheqësi i dashur i popullit tonë, shoku Enver Hoxha.

Një javë përpjekje dhe luftë në grykat e qafat e Funarsit, Prapanikës, Griqanit, Gurit të Zi, Labinotit e Priskës. Gjatë këtyre ditëve të gjitha orvatjet e armikut për t'u futur në këtë zonë u prapsën me humbje të mëdha për të. Sidomos qendresa heroike e partizanëve të Brigadës III ndërmjet Labinotit e Griqanit, i tronditi mjaft nazistët. Por ata grumbulluan forca e mjete të shumta nëpërmjet rrugëve të shpeshta. Rrahën me mortajë e artileri pozicionet e prapavijat tona. Me mjete të shpejta zunë disa pika të përparuara deri në Shëngjergj. Prej këndeje nëpër Fushë-Bixë-Gu-

rakuq-Orejë, deshën të rrethojnë nga të gjitha anët njësitet partizane. Brigada III dhe II e çanë rrethimin duke u hedhur në prapavijat gjermane, në zonën e Zaranikës e të Shëngjergjit.

Batalioni i Çermenikës mbeti i fundit. Ky nuk mundi të largohej nga zona e tij. Forcat e paka prej 50 vetësh, që kishin mbetur, u hodhën në luftë me gjermanët e ballistët mbi kodrat sipër Zdrajshës, ku armiku nuk la pozicion pa rrahur me mortajë. Gjithë ditën nuk pushoi pushka, megjithëse batalioni kishte pësuar humbje në disa shokë. Këtu mbetën udhëheqësit e rinisë së batalionit, anëtarët e Partisë, Bardhul Popa, Lumja (Shejnaz Juka) e Fehmi Kotherja. Kur afrohen partizanët t'i tërheqin shokët e tyre të vrarë, në mes të plumbave të armikut, Lumja e kish mbarruar gjithë gjerdanin e fishekëve. Vdekja e saj qe një vdekje heroike. E shtrirë barkas në pozicion, kishte mbështetur kokën mbi pushkë dhe ashtu e vrarë dukej sikur mbronte me fanatizëm pozicionin e vet. Një copë murtajë e kishte goditur në kokë, dhe gjaku i kishte ngrirë në flokët e zeza.

Sytë e saj të bukur e ruanin ende gjallërinë e tyre. Në ata sy gfaqej vullneti i saj i fundit: «Nazistët mund të kalojnë vetëm mbi trupin tim të vrarë». Dhe vetëm kështu kaluan me të vërtetë barbarët nazistë.

Në mbrëmje pushkët e mitrolozat u rralluan, dëgjohej vetëm krisma e mortajave gjermane, të cilat përpiqeshin të hapnin rrugën e ushtarëve për Orejë.

U err. Nuk shihej gjë veç flakës së pushkëve të rralla e të mortajave armike. Partizanët e batalioneve zbrazën me të shpejtë disa pushkë e mitroloza, me qëllim që të mos kuptonin forcat fashiste se po tërhiqen. Qëndruan në Orejë për disa minuta, sa të çlodhen. Pastaj, me korierin e palodhur e trim, Beqir Koçin, që i kishte përcjellë gjithnjë në këto zona, u drejtuan për Gurakuq e Fushë-Bixë. Nga partizanët asnjë nuk e dinte me saktësi vendin se ku do të shkonin. Komisari i kishte dhënë drejtimin qysh më parë Beqirit, i cili ecte në krye të kollonës me një pushkë të shkurtër italiane në krah. Kalonte shtigjet e rrugët e fshehta si të ishte ndonjë dhi e egër dhe si t'i dinte symbyllur. Beqiri bënte njëmijë dredha për të shpëtuar batalionin nga rrethimi.

Në mesnatë kapërcyem Fushë-Bixën dhe muarën nga e majta dhe mbas disa orësh rrugë pa rrugë arritëm në pyll ndërmjet Orejës dhe Martaneshit, afër qafës së Xixllës. Përpara batalionit posa kishte arritur edhe shoku Enver me anëtarët e shtabit të shoqëruar prej një skuadre partizanësh. Pamja dhe fjalët e tija të prera elektrizuan menjëherë të gjithë partizanët, sado që ishin të lodhur e pa bukë. Enveri u dha shpirt e forcë të gjithëve në situatën më të vështirë. Shkëmbeu disa fjalë të shkurtëra e

të prera me komisarën e batalionit dhe pastaj u vendosën disa roje në majë të shkëmbinjve, kurse të tjerët u shpërndanë në grupe për të fjetur. Por Enveri ynë nuk flinte. Qendronte në këmbë, veshur e armatosur, duke biseduar me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm.

Në dritën e zjarrit e të qiriut filloi të shkruante diçka; jepte udhëzimet dhe urdhërat e nevojshme, përgatiste planet për të kapërcyer në jug, atje ku pritej udhëheqja e tij për të drejtuar sulmin e ushtrisë partizane kundër hordhivë gjermano-balliste.

Kishim dy ditë pa bukë dhe s'kishim ku të merrnim, se barbarët fashistë me urën e zjarrit në dorë kishin grabitur e vrarë fshatarët, të cilët ishin fshehur nëpër pyje me gjithë fëmijë. Disa prej burrave e të rinjve kishin marrë aratinë, sidomos ata që ishin të lidhur me lëvizjen nacional-çlirimtare. Katundet kishin mbetur si të shkreta në ditët e para të operacionit. Njësitet partizane, që kalonin përmes pyjeve, dëgjonin pëshpëritjet e grave duke shtrënguar në gjë fëmijët e vegjël, që qanin nga të ftohtit.

Natën e dytë zu një shi i ftohtë. Ujët na hyri deri në palcë; s'kishim ku të futnim kokën. Disa shokë u përpoqën të ngrenë ndonjë fletë çadre sa për partizanët e plagosur e të sëmurë. E harruam fare urinë; buka përpara zjarrit u bë një gjë lluksi për të gjithë. Por ditën nuk mund të ndiznim asnjë lëmishte, se tymi mund të diktohej prej armikut. Secili priste natën me padurim për të terur rrobet, të cilat na ishin ngjitur pas trupit si me tutkall. Partizanët e udhëheqësit luftonin me urinë, me dimrin, me armikun, me vdekjen. Por qëndrojnë të papërkulur, se luftojnë për lirinë, për jetën.

Shiu binte pa pushim dhe shuante zjarret tona. Ai shuaj e në ndiz përsëri! Po në mëngjez mbeteshin vetëm thëngjijtë e hiri që ishte ndërruar në baltë. Megjithëse binte shi për kiamet, disa partizanë gërhitnin nëpër gjumë. Ishin kaq të raskapitur, sa nuk e ndjejnë fare shiun që u binte përsipër dhe ujin që u shkonte nën të si rrëke. Në rëzë të një ahu të madh qëndronte Haki Stërmilli me një batanie nën kokë dhe një qiri në dorë. Mallkonte me gjithë fuqinë e tij, se donte të shënonte diçka. Por shiu e shponte edhe batanien dhe i pikonte mbi fletët e ditarit. Dha e dha e më në fund e mbylli fletoren se nuk ishte punë që bëhej.

Uria po na i shtrëngonte rrypat. Po, përpara shiut dhe të ftohtët, të keqen e urisë! Një kasolle me kashtë atë natë do të ishte një pallat më lluksoz se «Hotel Dajti», ku tradhëtarët e ballit dhe të legalitetit kërcenin e pinin me pushtuesit gjermanë. Partizanët shtrëngonin grushtat me zemërim. Urrejtja dhe hakmarrja e drejtë rriteshin, forcoheshin dhe kalonin çdo kufi. Armiku fashist e